Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI - PROCUREMENT REVIEW BODY
Nr./Br. 695-701/20
Data/Datum: 22.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.695/20
701/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.N.SH "TOP PROJEKT"-Prishtinë, si dhe OE "EBK"SH.P.K-Prizren, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE: N.N.T "Etniku": "KAG Asphalt Company" Sh.p.k-Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi objektit të ri të shkollës ne fshatin Pllanjanë", me nr. të prokurimit: 622-20-2683-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KK PRIZREN, më datën: 21.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: N.N.SH "TOP PROJEKT"-Prishtinë si dhe OE: "EBK"SH.P.K-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi objektit te ri te shkollës ne fshatin Pllanjanë", me nr. të prokurimit: 622-20-2683-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KK PRIZREN.

II. **ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi objektit te ri te shkollës ne fshatin Pllanjanë", me nr. të prokurimit: 622-20-2683-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KK Prizren, dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik: N.N.SH "TOP PROJEKT"-Prishtinë si dhe OE: "EBK"SH.P.K-Prizren, aprovohen pjesërisht si te bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.N.SH "TOP PROJEKT"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.09.2020 me nr. 695/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi objektit te ri te shkollës ne fshatin Pllanjanë", me nr. të prokurimit: 622-20-2683-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KK Prizren, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 56, 59, 60, 61, 65, 66, 72, si dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues "EBK"SH.P.K-Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.09.2020 me nr. 701/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi objektit te ri te shkollës ne fshatin Pllanjanë", me nr. të prokurimit: 622-20-2683-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- KK Prizren, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 7, 59, 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 39.8 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.09.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 05.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "EBK"SHPK - Prizren

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ebk" Shpk, se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të

tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE N.N.T "Etniku";"KAG Asphalt Company" Shpk, e cila nuk përmbush kërkesën e kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe oferta e OE të rekomanduar për kontratë duhej të shpallej e papërgjegjshme, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qenë prej jo më pak se 1.600.000,00 €, e dëshmuar me pasqyrat e qarkullimit financiar të kompanisë, të shoqëruar me qarkullim financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.

OE i rekomanduar për kontratë N.N.T "Etniku";"KAG Asphalt Company" Shpk së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe deklaratat vjetore të qarkullimit financiar për tri vitet e fundit të dorëzuara në ATK sipas kësaj gjendje të qarkullimit.

1. Viti 2019 -qarkullimi bruto 941,408.05 €
2. Viti 2018 -qarkullimi bruto 745,761.55 €
3. Viti 2017 - qarkullimi bruto 219,991.42 €
Totali - qarkullimi 1,907,161.02 €

Eksperti shqyrtues konstaton se vetëm deklaratat e qarkullimit financiar të liderit të konzorcioumit N.N.T "Etniku" ;"KAG Asphalt Company" Shpk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit ku janë kërkuar jo më pak se 1,600,000.00 € qarkullim financiar për tri vitet e fundit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimin 2.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Ebk" Shpk, se oferta e rekomanduar për kontratë nga AK nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit jo më pak se 1,200,000.00 €, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të dorëzojnë projektet e natyrës së kontratës të realizuara në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.200.000,00 €, e dëshmuar me listën e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal

të pranimit përfundimtar të punëve.

OE i rekomanduar për kontratë N.N.T "Etniku" ;"KAG Asphalt Company" Shpk ka dorëzuar dy lista të kontratave të realizuara për të dy anëtarët ë konzorciumit se bashku me kontratat dhe referencat për

realizimin e kontratave.

Eksperti shqyrtues sqaron se lideri i konzorciumit N.N.T "Etniku" ka dorëzuar kontratën dhe referencën për ndërtimin e palestrës sportive në Studençan, ndërtimi i tregut ditor me karakter lokal në Suharekë, ndërtimi i qendrës së mjekësisë familjare në Rahovec, si dhe shume kontrata dhe referenca të projekteve infrastrukturore. Gjithashtu, janë dorëzuar edhe kontrata dhe referenca për realizimin e punimeve për anëtarin tjetër të konzorciumit "KAG Asphalt Company" Shpk të cilat janë të fushës infrastrukturës.

Eksperti shqyrtues konstaton se kontratat dhe referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë tejkalojnë vlerën e kontratave dhe referencave prej 1,200,000.00 € e kërkuar në parashtrimin e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Sipas ekspertit shqyrtues meqenëse në kërkesën c dosjes së tenderit është specifikuar që kontratat duhet të jenë të natyrës së kontratës dhe në para masën e punëve që duhet të kryhen në këtë aktivitet të prokurimit ka pozicione dhe punë të infrastrukturës (rrethimi i shkollës, ndërtimi i murit mbrojtës, rregullimi parkingut, punët e rrugës, etj). kontratat dhe referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë të natyrës së projekteve infrastrukturore janë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ebk" Shpk, se oferta e rekomanduar për kontratë nga AK nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar që OE duhet të kenë në pronësi së paku dy kamion të tonazhit 5-10 ton (pesha bartëse), eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka në pronësi së paku dy kamion të tonazhit nga 5 -10 ton (pesha bartëse),e dëshmuar me libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve. OE i rekomanduar për kontratë N.N.T "Etniku" ;"KAG Asphalt Company" Shpk ka dorëzuar listën e pajisjeve për të dy anëtarët e konzorciumit së bashku me librezat e regjistrimit të automjeteve dhe një marrëveshje mbi shfrytëzimin c makinerisë të liderit të konzorciumit N.N.T "Etniku" ku janë të specifikuara edhe dy kamion. Eksperti shqyrtues konstaton se pajisjet, librezat e regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshja mbi shfrytëzimin e makinerisë të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit mbi kapacitetin teknik dhe profesional. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 4.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën tjetër të kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të ketë së paku 30 të punësuar me profile të ndryshme adekuate për realizimin e kontratës, ku lideri i konzorciumit kërkohet që të këtë 18 nga ta që

sipas OE ankues lideri i konzorciumit nuk e ka prezantuar këtë numër të stafit dhe kjo ofertë duhet të shpallej e papërgjegjshme, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ketë së paku 30 të punësuar me profile të ndryshme adekuate për realizim të kontratës e dëshmuar me listën e të punësuarve në tre muajt e fundit e paraqitur në ATK bashkë me përshkrim të shkurtër të vendit të punës për stafin ose kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohëzgjatja e realizimit të këtij projekti.

Lideri i konzorciumit N.N.T "Etniku" ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së në të cilën rezultojnë 14 të punësuar në tremujorin e parë të vitit 2020 (kërkesa e dosjes së tenderit).

Me datë 27.08.2020,AK përmes letrës standarde për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarime lidhur me numrin e punëtorëve konform kërkesës së tenderit, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë në përgjigjen e tij ka dorëzuar disa para kontrata të datës 20.07.2020 në të cilat janë specifikuar titulli i këtij projekti dhe kohëzgjatja e këtyre para kontratave do të jetë deri në përfundim të këtij projekti. Eksperti shqyrtues konstaton se në dosje të tenderit është specifikuar që OE duhet të ofrojnë listën e të punësuarve në ATK në tre muajt e fundit ose kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohëzgjatja e realizimit të këtij projekti, andaj lista e të punësuarve në ATK për 14 punëtor/staf dhe një numër i madh i para kontratave të dorëzuara më vonë me kërkesë të AK konform nenit 72 të LPP-së e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit për liderin e konzorciumit dhe pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues NNSH"TOP PROJEKT" - Prishtinë

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt", se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të ketë së paku 30 të punësuar me profile të ndryshme adekuate për realizimin e kontratës, ku lideri i konzorciumit kërkohet që të ketë 18 nga ta, e që sipas OE ankues lideri i konzorciumit nuk e ka prezantuar këtë numër të stafit dhe kjo ofertë duhet të shpallej e papërgjegjshme, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ketë së paku 30 të punësuar me profile të ndryshme adekuate për realizim të kontratës e dëshmuar me listën e të punësuarve e paraqitur në ATK në tre muajt e fundit bashkë me përshkrim të shkurtër të vendit të punës për stafin ose kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohëzgjatja e realizimit të këtij projekti.

Lideri i konzorciumit N.N.T "Etniku" ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së në të cilën rezultojnë 14 të punësuar në tremujorin e parë të vitit 2020 (kërkesa e dosjes së tenderit). Me datë 27.08.2020, AK përmes letrës standarde për sqarimin e tenderit ka kërkuar sqarime lidhur me numrin e punëtorëve konform kërkesës së tenderit, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë në përgjigjen e tij ka dorëzuar disa para kontrata të datës

20.07.2020 (data e dorëzimit të tenderit) në të cilat janë specifikuar titulli i këtij projekti dhe kohëzgjatja e këtyre para kontratave do të jetë deri në përfundim të këtij projekti. Eksperti shqyrtues konstaton se në dosje të tenderit është specifikuar që OE duhet të ofrojnë listën c të punësuarve në ATK në tre muajt e fundit ose kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohëzgjatja e realizimit të këtij projekti, andaj lista e të punësuarve në ATK për 14 punëtor/staf dhe një numër i madh i para kontratave të dorëzuara me vonë me kërkesë të AK konform nenit 72 të LPP-së e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit për liderin e konzorciumit dhe pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues N.N.SH "Top Projekt", se anëtari konzorciumit të rekomanduar për kontratë "KAG Asphalt Company" Shpk ka dorëzuar Vërtetimin Tatimor të ATK-së ku thuhet: Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura, dhe sipas OE ankues ky vërtetim nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe OE i rekomanduar për kontratë duhej të shpallej i papërgjegjshëm, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Më kërkesë të AK-së, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Vërtetimin Tatimor të ATK-së për të dy anëtarët e konzorcimumit. Në Vërtetimin Tatimor të ATK-së për anëtarin "KAG Asphalt Company" Shpk i nxjerrë nga sistemi i ATK-së me datë 31.08.2020 specifikohet që ky OE është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore.

Në dosje të tenderit është specifikuar që OE (vetëm fituesi duhet të ofroj një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

Bazuar në interpretimin e KRPP-së, se për të qenë një OE i pranueshëm duhet që marrëveshja për shlyerjen e borxheve të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës, andaj Vërtetimi Tatimor i OE "KAG Asphalt Company" Shpk i datës 31.08.2020 nuk qartëson nëse ky OE ka qenë me vonesë në shlyerjen e borxheve në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës apo borxhet kanë lindur më vonë pas datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se lideri grupit i OE "Ebk" Shpk; NTPSH "Vëllezërit e bashkuar" Shpk nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit jo më pak se 1,200,000.00€, ku lideri duhet ti ketë se paku 60% të referencave, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Lideri i grupit "Ebk" Shpk; do dorëzuar listën e projekteve dhe kontratave të realizuara së bashku me

referencat në vlerë prej 1,594,040.13 €.Eksperti shqyrtues sqaron se të gjitha kontratat dhe referencat e dorëzuara nga lideri i grupit janë konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe përmbushin vlerën e kërkuar prej 60 % të vlerës së kontratave, Lideri i grupit ka dorëzuar kontrata dhe referenca për projektet e realizuara që tejkalojnë vlerën prej 1,200,000.00€, andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 4.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se grupi i OE "Edibau-ing" Shpk; NPT "Bamirs" nuk e përmbushin kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit jo më pak se 1,200,000.00€, sepse nuk kanë dorëzuar listën e kontratave konform kërkesës së dosjes së tenderi, eksperti shqyrtues sqaron se ky grupi i OE ka dorëzuar kontratat dhe referencat për realizimin e punëve që përmbushin shumën prej 1,200,000.00€ e parashtruar në dosjen e tenderit. AK konform nenit 72 të LPP-së dhe RRUOPP-së nga OE ka mundur të kërkoj listën e kontratave. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Sa i përket pretendimit tjetër së lideri i grupit të OE "Edibau-ing" Shpk;NPT "Bamirs" ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së që nuk i ka min. 18 punëtor/staf siç është kërkuar në dosje të tenderit që Lideri duhet ti ketë 60% të stafit apo min. 18 nga 30/staf sa janë kërkuar. eksperti shqyrtues sqaron se lideri i grupit OE "Edibau-Ing" ka dorëzuar listën e punëtorëve/stafit të ATK-së dhe për muajt prill dhe maj/2020 sipas kësaj deklarate janë 21 punëtor që për ekspertin shqyrtues dëshmia e ofruar e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit, andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 5.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se grupi i OE NTP "B-Ademaj"; MBB "Construction" Shpk nuk e përmbushin kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit jo më pak se 1,200,000.00€, eksperti shqyrtues sqaron se në ofertën e tyre ky grup ka dorëzuar listat e kontratave, kontratat dhe referencat të cilat kanë të bëjnë më shumë me furnizime sesa me realizim të punimeve siç është kërkuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues konstaton se kontratat dhe referencat e dorëzuara nga grupi i OE NTP "B-Ademaj";MBB "Construction" Shpk që kanë të bëjnë me realizim të punimeve nuk e plotësojnë shumën prej 1,200,000.00 € siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon

panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen pjesërisht si të bazuara dhe rekomandon autoritetin kontraktues qe të vazhdoj me lidhjen e kontratës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 05.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik N.N.SH "TOP PROJEKT"-Prishtinë me datë 07.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues. Ku sqaron, ju njoftojmë se nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues të datës 05.10.2020 me numër të protokollit 695-701-20 dhe kërkojm nga Paneli shqyrtues i OSHP-së në seancën përfundimtare të shqyrtoj mosrespektimin e LPP-së nga AK-ja dhe të mos e merr parasysh fare Raportin e ekspertit shqyrtues.

Pretendimi 1

Ju njoftojmë edhe njeher se OE ka dorëzuar një liste te puntorve nga ATK-ja te datës 20.07.2020 ku dëshmohet se OE ka te punësuar 12 puntorë ,ka dorëzuar edhe 4 inxhinier me kontratë mbi vepër dhe ate : Idriz Seferaj ing. I ndertimit –projektmenagjer , Veton Kukaj ing.i Makineris, Malush Muslija –ing i elektrons , Donjeta Berisha –ing e hidrës.

Pra OE ka prezantuar ne DT 12+4=16 te punësuar me pak se 18 qe ka qen minimumi për Liderin e Konzorciumit .-rrjedhimisht OE është i papërgjegjshëm.

Ne letren standarde AK-ja ka kërkuar sqarime ne baze te nenit 72 nga OE dhe ne kundërshtime LPP-në ka pranuar dokumente ekzistenca e te cilave nuk mund te vërtetohet se ka qene para hapjes se tenderit , OE ne kundërshtim me Ligjet ne fuqi te Republikës se Kosovës ka dorëzuar dokumente shtesë.

Neni 72

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

1. Kur informacioni apo dokumentacioni qe duhet te dorzohet nga operatoret ekonomik eshte ose duket te jete jo i plote ose i gabuar , ose kur mungojn dokumentet specifike , autoritetet kontraktuese mund te kerkojn nga operatoret ekonomik qe te dorzojne , plotsojn , sqarojn apo kompletojn informacione apo dokumentacionin e duhur brenda nje afati te caktuar kohor, me kusht qe kërkesat e tilla bëhen ne përputhje te plote me parimet e trajtimit te barabarte dhe transparencës.
2. Autoriteti Kontraktues mund te ftoje operatoret ekonomik per te plotësuar apo te qartësoj certifikatat dhe dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenet 65-71 te këtij ligji.
3. Sigurimi i informacioneve qe mungon ose ofrimi i informacioneve do te aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencës e te cilave është e fiksuar , para skadimit te afatit pre dorëzimin e tenderëve , dhe mund te verifikohet ne mënyrë objektive.

I kemi bere me dije AK-së ne kerkesen per Rishqyrtim se ne baze te neneit 72 pika 3, OE nuk ka pasur te drejt te dorzoj lista tjera shtese me dt28.08.2020 (gjoja se eshte bere me dt 20.07.2020 diten e dorzimit) dhe nuk ka pasur te drejt te kërkoj kontrata mbi veper per kete projekt dhe te përmbush 18 punëtor sepse ne një rate tjetër një OE ne te ardhmen mund te kërkohet dhe te sjell 1000 te punësuar , mund te sjell Deklaratën nen Betim , mund te sjell Sigurimin e tenderit , Vlefshmërinë e tenderit etj etj.
Bashkangjitur gjeni dokumentacionin për ketë pretendim 1

Pretendimi 2
Eksperti shqyrtues nuk e ka analizuar mirë Pretendimin 2 , sepse i rikujtojmë ekspertit shqyrtues se OE ka ne total 708 072,25 euro referenca te natyrës se njëjtë qe nuk e plotëson 720 000 te kërkuar për Liderin.
Bashkangjitur gjeni dokumentacionin për ketë pretendim 2
Përfundim : Kerkojm nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit qe te mos e merr parasysh raportin e ekspertit shqyrtues dhe ankesën ton ta Aprovoj si te bazuar dhe lenden ta kthej ne Rivlerësim , dhe gjatë Rivlerësimit ne te shpallemi fitues si Oferta me çmimin me te lirë te përgjegjshëm.

Te bashkangjitur ka listën e punëtoreve dhe disa dokumente tjera lidhur me përgjigjen
Operatori Ekonomik, "EBK"SH.P.K-Prizren me datë: 06.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues. Nga OSHP kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues te prokurimit lidhur me aktivitetet e lart cekura me te culen ka aprovuar pjesërisht si te bazuar ankesën ton ndërsa ka len ne fuqi vendimin e autoritetit kontraktues Komuna Prizrenit për dhenjen e kontratës . Ne kundershtojm dhe kerkojm nga paneli shqyrtues qe te mbaje seanc dhe te shqyrtoj te gjitha pretendimet tona ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit , pasi qe eksperti i lendes nuk ka bere vlerësim te dret dhe nuk eshte bazuar ne dispozitat ligjore te LPP-së.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 21.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Ebk" Shpk, se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE N.N.T "Etniku";"KAG Asphalt Company" Shpk, e cila nuk përmbush kërkesën e kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe oferta e OE të rekomanduar

për kontratë duhej të shpallej e papërgjegjshme

Paneli Shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qenë prej jo më pak se 1.600.000,00€, e dëshmuar me pasqyrat e qarkullimit financiar të kompanisë, të shoqëruar me qarkullim financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. OE i rekomanduar për kontratë N.N.T "Etniku";"KAG Asphalt Company" Shpk së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar edhe deklaratat vjetore të qarkullimit financiar për tri vitet e fundit të dorëzuara në ATK, ku për vitin 2019 me qarkullim bruto 941,408.50€, për vitin 2018 me qarkullim bruto prej 745,761.55€ dhe për vitin 2017 me qarkullim 219,991.42€ apo në total me qarkullim prej 1,907,161.02€. Pra, vetëm deklaratat e qarkullimit financiar të liderit të konzorcioumit N.N.T "Etniku" ;"KAG Asphalt Company" Shpk e plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit ku janë kërkuar jo më pak se 1,600,000.00 € qarkullim financiar për tri vitet e fundit. Andaj, ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues "Ebk" Shpk, se oferta e rekomanduar për kontratë nga AK nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit jo më pak se 1,200,000.00€.

Paneli Shqyrtues sqaron se kërkesë e AK-së ka qenë që OE duhet të ketë kontrata të natyrës së ngjashmë jo më pak se 1,200,000.00 euro, ku lideri ti këtë së paku 60% të referencave, që i bie se lideri duhet ti ketë të paktën referencat në shumë prej 720,000.00 euro. Andaj, AK duhet që të kërkoj sqarime shtesë dhe të sqaroj këtë pretendim.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues "Ebk" Shpk, se oferta e rekomanduar për kontratë nga AK nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar që OE duhet të kenë në pronësi së paku dy kamion të tonazhit 5-10 ton (pesha bartëse).

Paneli Shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka në pronësi së paku dy kamion të tonazhit nga 5 -10 ton (pesha bartëse), e dëshmuar me libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve. OE i rekomanduar për kontratë N.N.T "Etniku" ;"KAG Asphalt Company" Shpk ka dorëzuar listën e pajisjeve për të dy anëtarët e konzorciumit së bashku me librezat e regjistrimit të automjeteve dhe një marrëveshje mbi shfrytëzimin e makinerisë të liderit të konzorciumit N.N.T "Etniku" ku janë të specifikuara edhe dy kamion.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e OE ankues "Ebk" Shpk se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën tjetër të kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të ketë së paku 30 të

punësuar me profile të ndryshme adekuate për realizimin e kontratës, ku lideri i konzorciumit kërkohet që të këtë 18 nga ta që sipas OE ankues lideri i konzorciumit nuk e ka prezantuar këtë numër të stafit dhe kjo ofertë duhet të shpallej e papërgjegjshme.
Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se autoriteteve kontraktues nuk u lejohet që me rastin e kërkesës për sqarime shtesë të pranojnë dokumente ekzistenca e të cilave nuk vërtetohet se ka qenë para hapjes së tenderit. Andaj, AK me rastin e ri vlërësimit duhet të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 duke sqaruar ekzistencën e këtyre dokumenteve dhe të bëjë vlerësimin konform kësaj kërkese të dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt", se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të ketë së paku 30 të punësuar me profile të ndryshme adekuate për realizimin e kontratës, ku lideri i konzorciumit kërkohet që të ketë 18 nga ta, e që sipas OE ankues lideri i konzorciumit nuk e ka prezantuar këtë numër të stafit dhe kjo ofertë duhet të shpallej e papërgjegjshme. Po ashtu, OE ankues përmes parashtresës ka bashkangjitur edhe disa shkresa ku pretendon se AK në letrën standarde ka kërkuar sqarime në baze te nenit 72 nga OE dhe në kundërshtime LPP-në ka pranuar dokumente ekzistenca e të cilave nuk mund të vërtetohet se ka qenë para hapjes së tenderit.
Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se autoriteteve kontraktues nuk u lejohet që me rastin e kërkesës për sqarime shtesë të pranojnë dokumente ekzistenca e të cilave nuk vërtetohet se ka qenë para hapjes së tenderit. Andaj, AK me rastin e ri vlërësimit duhet të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 duke sqaruar ekzistencën e këtyre dokumenteve dhe të bëjë vlerësimin konform kësaj kërkese të dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues N.N.SH "Top Projekt", se anëtari konzorciumit të rekomanduar për kontratë "KAG Asphalt Company" Shpk ka dorëzuar Vërtetimin Tatimor të ATK-së ku thuhet: Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura, dhe sipas OE ankues ky vërtetim nuk është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe OE i rekomanduar për kontratë duhej të shpallej i papërgjegjshëm.
Paneli Shqyrtues sqëaron se me kërkesë të AK-së, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Vërtetimin Tatimor të ATK-së për të dy anëtarët e konzorcimumit. Në Vërtetimin Tatimor të ATK-së për anëtarin "KAG Asphalt Company" Shpk i nxjerrë nga sistemi i ATK-së me datë 31.08.2020 specifikohet që ky OE është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore. Në dosje të tenderit është specifikuar që OE (vetëm fituesi duhet të ofroj një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të

Njoftimit të Kontratës.

Bazuar në interpretimin e KRPP-së, se për të qenë një OE i pranueshëm duhet që marrëveshja për shlyerjen e borxheve të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës, andaj Vërtetimi Tatimor i OE "KAG Asphalt Company" Shpk i datës 31.08.2020 nuk qartëson nëse ky OE ka qenë me vonesë në shlyerjen e borxheve në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës apo borxhet kanë lindur më vonë pas datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. Andaj, ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar dhe i mbetet AK që të konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt", se lideri grupit i OE "Ebk" Shpk; NTPSH "Vëllezërit e bashkuar" Shpk nuk e përmbush kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional ku është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit jo më pak se 1,200,000.00€, ku lideri duhet ti ketë se paku 60% të referencave.

Paneli Shqyrtues sqaron se kërkesë e AK-së ka qenë që OE duhet të ketë kontrata të natyrës së ngjashmë jo më pak se 1,200,000.00 euro, ku lideri ti këtë së paku 60% të referencave, që i bie se lideri duhet ti ketë të paktën referencat në shumë prej 720,000.00 euro. Andaj, AK duhet që të kërkoj sqarime shtesë dhe të sqaroj këtë pretendim.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt", se grupi i OE "Edibau-ing" Shpk; NPT "Bamirs" nuk e përmbushin kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit jo më pak se 1,200,000.00€, sepse nuk kanë dorëzuar listën e kontratave konform kërkesës së dosjes së tenderi. Paneli Shqyrtues sqaron se ky grup i OE ka dorëzuar disa kontrata dhe referenca për realizimin e punëve që nuk përmbushin shumën prej 1,200,000.00€ e parashtruar në dosjen e tenderit. Megjithatë, AK konform nenit 72 të LPP-së dhe RRUOPP-së nga OE duhet të kërkoj listën e kontratave dhe të sqaroj se a janë të natyrës së ngjashme. Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues N.N.SH "Top Projekt", se lideri i grupit të OE "Edibau-ing" Shpk;NPT "Bamirs" ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së që nuk i ka min. 18 punëtor/staf siç është kërkuar në dosje të tenderit që Lideri duhet ti ketë 60% të stafit apo min. 18 nga 30/staf sa janë kërkuar. Paneli Shqyrtues ka dhënë sqarimin më lartë për këtë pikë ankimore

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt" se grupi i OE NTP "B-Ademaj"; MBB "Construction" Shpk nuk e përmbushin kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar që OE duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e fundit jo më pak se

1,200,000.00€.

Paneli Shqyrtues sqaron se në ofertën e tyre ky grup ka dorëzuar listat e kontratave, kontratat dhe referencat të cilat kanë të bëjnë më shumë me furnizime sesa me realizim të punimeve siç është kërkuar për këtë aktivitet të prokurimit. Paneli Shqyrtues vlerëson se kontratat dhe referencat e dorëzuara nga grupi i OE NTP "B-Adcmaj";MBB "Construction" Shpk që kanë të bëjnë me realizim të punimeve nuk e plotësojnë shumën prej 1,200,000.00 € siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, vjen në përfundim se AK gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që me rastin e ri vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK PRIZREN;

1x1 OE N.N.SH "TOP PROJEKT"-Prishtinë;

1x1 OE "EBK"SH.P.K-Prizren;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.